4. Programi për Informim, mbështet shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve. Këtë e realizon përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, publikimeve dhe uebfaqes së ATRC-së.

ATRC beson se ndërtimi i koalicioneve dhe partneriteteve ndërsektoriale janë shtylla kyçe për arritjen e qëllimit dhe përmbushjen e misionit të saj. Për këtë arsye, ATRC është në bashkëpunim të vazhdueshëm me OJQ të shumta në Kosovë, është pjesë e fushatave avokuese që kanë për qëllim zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje si dhe është pjesë e rrjeteve në nivel lokal, regional e ndërkombëtar.

MISIONI

Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) është organizatë jofitimprurëse Kosovare, e cila angazhohet për rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe shoqërisë civile në vendimmarrje, si kusht për një shoqëri të zhvilluar demokratike dhe stabile rajonale.

ATRC ndihmon në forcimin e rolit të OJQ-ve si agjent të ndryshimit në shoqëri, ngrit kapacitetin e OJQ-ve dhe iniciativave qytetare që të ndërrmarin fushata

avokimi dhe kontribuon në krijimin e institucioneve qeverisëse bazuar në standardet ndërkombëtare.

ATRC punon me përfaqësues të OJQ-ve, iniciativat qytetare, administratën publike dhe me institucionet politike pa dallim feje, gjinie, etnie, moshe, aftësie, përkatësie politike dhe orientimi seksual.

PARTNERËT DHE PËRKRAHËSIT

Gjatë vitit 2014 ATRC ka vazhduar bashkëpunimin me organizata e institucione të ndryshme qeveritare në nivele lokale dhe nacionale, me organizata joqeveritare Kosovare dhe ndërkombëtare, në inicimin dhe implementimin e projekteve të përbashkëta.

Institucionet dhe agjencitë qeveritare me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2014:

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KÇJK)
Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK)
Zyra e Prokurorit Disiplinor (KPD)
Inspektorati Policor i Kosovës (IPK)
Policia e Kosovës (PK)
Zyra e Avokatit të Popullit (ZAP)
Gjykatat Themelore dhe Degët e Gjykatave Themelore (GJTH)
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Departamenti i Energjisë (MZHE)
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH)
Pesë Komuna të Kosovës: Prizren, Gjiilan, Viti, Kamenicë dhe Novobërdë.

Organizatrat joqeveritare rajonale me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2014:

SEE Change Net - Bosnjë dhe Hercegovinë
EDEN, Ekolëvizja dhe CO-PLAN - Shqipëri
CZZS dhe Public Interest Advocacy Center - Bosnjë dhe Hercegovinë
Society for Sustainable Development Design dhe Forum for Freedom Education – Kroaci
Association for Policy Research Analytica – Maqedoni
Eko-Svest dhe Environmental Citizens' Association - Maqedoni
Green Home dhe MANS - Mali i Zi
Fractal, CEKOR dhe EASD – Serbi
Fondazione Punto.Sud - Itali
TEMA – Turqi
EEB - Belgjikë

Organizatrat Joqeveritare lokale me të cilat ATRC ka bashkëpunuar gjatë vitit 2014:
Shoqëria e avokatëve “Sejdiu & Qerkini,” sh.p.k. – Prishtinë
Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) - Prishtinë
Civil Rights Program in Kosovo (CRP/K) - Prishtinë

Përkrahësit e ATRC-së gjatë vitit 2014 kanë qenë:

Agjensioni i Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID)

<http://www.usaid.gov/kosovo>

Departamenti Amerikan i Shtetit përmes Grupit të së Drejtës dhe Politikave Ndërkombëtare Publike (PILPG)

www.justiceandthepeople.org

Agjensioni i Suedisë për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) www.sida.se

Qendra Ndërkombëtare Olof Palme www.palmecenter.org

Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR) <http://www.unhcr.org>;

Komisioni European/The Balkan Trust for Democracy-BTD/The United Nations Development Programme-

UNDP http://ec.europa.eu/enlargement/index_en.htm/, <http://www.gmfus.org/balkantrust/>

<http://www.ks.undp.org/>

Këshilli i Evropës

http://www.coe.int/t/dg4/cultureheritage/cooperation/Kosovo/default_en.asp

PROGRAMI PËR TRAJNIME DHE NGRITJE KAPACITETESH

Ky program ka për qëllim t'ju ofroj OJQ-ve metodat dhe mjetet e duhura për të iniciuar ndryshime në komunitetet e tyre. Dita ditës këto organizata ballafaqohen me sfida të reja dhe nevojat e tyre nuk janë të njëjta si më parë, andaj edhe ATRC në vazhdimësi ndryshon

Gjatë vitit 2014, ATRC në kuadër të projekteve ka realizuar 34 trajnime dhe punëtori. Përfitues të këtyre trajnimeve dhe punëtorive ishin OJQ, qytetarë dhe institucione të ndryshme. Gjithashtu, ATRC në bashkëpunim me Misionin e OSBE në Kosovë ka realizuar edhe dy trajnime për Rritjen e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Temat e përfshira në programin e trajnimeve:

- Dizajnimi i Projekt Propozimit
- Menaxhimi i Ciklit të Projektit
- Menaxhimi i OJQ-ve dhe Ngritja e fondeve
- Avokimi dhe Ndërtimi i Koalicioneve
- Roli i OJQ-ve në Shoqërinë Civile
- Qeverisja e Mirë
- Lidërshipi dhe Menaxhimi
- Planifikimi Strategjik
- Monitorimi dhe Vlerësimi

programin e saj duke prezantuar trajnime më të avancuara dhe me tema të reja, në mënyrë që nevojat e përfituesve të saj të reflektohen në këtë program.

- Marëdhëniet Ndërmjet OJQ-ve dhe Mediave
- Komunikimi Efektiv
- Komunikimi me Klient
- Menaxhimi Bazik Financiar
- Marrëdhëniet me Publikun dhe Marketingu
- Menaxhimi i Konfliktëve
- Negociatat
- Qeverisja me Pjesëmarrje
- Planifikimi Kooperues
- Buxhetimi me Pjesëmarrje
- Infrastruktura ligjore që reflekton punën e komunave në Kosovë
- Mekanizmat e përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse
- Funksionimi i qeverisë lokale
- Planifikimi i projekteve në komunitet
- Barazia gjinore

KONSULENCAT INDIVIDUALE

Ndryshe nga trajnimet formale të cilat u dedikohen një audience më të madhe, konsulencat janë të dizajnuara për të adresuar nevojat specifike të individëve dhe organizatave në mënyrë të veçantë. Për këtë arsye, ATRC praktikon metodën e kombinimit të dy shërëbimeve: trajnimet me konsulencë individuale, duke synuar të përmbush sa më mirë nevojat e çdo përfituesi dhe njëkohësisht të ngris efektivitetin e programit të saj.

Gjatë vitit 2014, ATRC ka mbajtur 54 konsulencë individuale për organizatat përfituese të USAID/ATRC në kuadër të projektit "Rritja e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë", në implementimin e projekteve dhe menaxhimin financiar.

PROGRAMI PËR MENAXHIMIN E GRANTEVE SJELLJA E DREJTËSISË MË AFËR QYTETARËVE NGRITJA E VETËDIJES SË QYTETARËVE DHE PJESËMARRJES NË SISTEMIN E DREJTËSISË

Gjatë vitit 2014, Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC) ka vazhduar implementimin e projektit të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për qasjen në drejtësi me titull “Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe pjesëmarrjes në sistemin e drejtësisë”, në kuadër të programit USAID Forward.

Në muajin shkurt 2014, 12 organizata lokale janë shpërblyer për të implementuar projekte në mbarë Kosovën, për Rundin e dytë të granteve, i cili është shpallur përmes kërkesës për parashtrimin e aplikacioneve (KPA) në muajin nëntor 2013.

Gjithashtu, në muajin gusht 2014, ATRC ka shpallur Rundin e tretë të granteve, përmes kërkesës për parashtrimin e aplikacioneve (KPA). Objektivat e grantit (eve) sipas Ftesës për Aplikim kanë qenë të shtohet qasja e qytetarëve të Kosovës në sistemin gjyqësor, duke i vënë organizatat vendore përballë sistemit gjyqësor në përgjithësi si dhe përballë sfidave dhe mundësive për funksionim më të mirë të gjykatave dhe për vënie të drejtësisë në gjykata në nivelin lokal; që të shtohet vetëdija publike dhe besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, në mënyrë që qytetarët të marrin pjesë në debate në mënyrë efektive dhe t’i mbështetin në mënyrë proaktive përpjekjet e institucioneve të sektorit të sistemit të drejtësisë dhe shoqërisë civile për ta shtuar transparencën, për ta luftuar korrupsionin dhe për të siguruar qasje të barabartë në drejtësi përmes administrimit të drejtë, transparent dhe efektiv të drejtësisë në Kosovë.

Kërkesa për parashtrimin e aplikacioneve (KPA) është publikuar në media të ndryshme të shkruara dhe

elektronike. Në mënyrë që të ofrohen informata më të detajuara për procesin e aplikimit për grante ATRC ka organizuar konferencë për media në Prishtinë si dhe nëntë sesione informuese në nëntë komuna të Kosovë: Prishtinë, Pejë, Prizren, Gjiilan, Mitrovicë, Mitrovicë veriore, Shtërpce, Gracanicë dhe Ferizaj.

Procesi i vlerësimit të dhënies së granteve është proces i hapur dhe transparent, i cili realizohet nga Bordi për Grante dhe Shpërblime (BGSh) dhe përbëhet nga tre anëtarë të jashtëm, të cilët janë të ndryshëm në secilin rund të granteve.

Më 24 tetor 2014, 15 organizata lokale janë shpërblyer për të implementuar projekte në mbarë Kosovën, për Rundin e tretë të granteve. Organizatat përfituese të granteve, të financuara përmes këtij projekti, kanë synuar që të:

- Shtojnë vetëdijen e qytetarëve dhe pjesëmarrjen në sistemin e drejtësisë;
- Shtojnë numrin e përgjithshëm të njerëzve nga komuniteti të përfshirë në nismat e monitorimit të gjykatave;
- Shfrytëzojnë informatat e mbledhura gjatë monitorimit të gjykatave me qëllim të reko mandimit të përmirësimeve apo për të avokuar për ndryshim;
- Shtojnë njohuritë brenda komunitetit lokal për gjykatat lokale.

Në vazhdim ju ofrojmë një pasqyrë të shkurtër të të gjitha projekteve të cilat janë shpërblyer me grante gjatë vitit 2014:

ROUNDI II

Projektet e monitorimit të gjykatave, që kanë për qëllim përmirësimin e marrëdhënieve gjykatë-ko munitet:

Përfituesi: Polis

Titulli i Projektit: Drejtësia me qasje të qytetarëve në shërbime korrekte gjyqësore II

Lokacioni i Organizatës: Lipjan

Lokacioni i Projektit: Lipjan

Kohëzgjatja e projektit: 9 muaj

Fondet e projektit: US \$ 9,900

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit

Projekti "Drejtësia me qasje të qytetarëve në shërbime korrekte gjyqësore II", fokusohet në monitorimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës dega në Lipjan për rastet e trashëgimisë, me fokus te gratë. Synimi i përgjithshëm i këtij projekti konsiston në vazhdimin e partneritetit të besimit të ndërtuar ndërmjet qytetarëve dhe gjyqësorit, për të siguruar një proces sa më efikas, transparent dhe të përgjegjshëm gjyqësor për qytetarët, nëpërmjet sigurimit të përfshirjes së publikut.

Përfituesi: Elita

Titulli i Projektit: Gratë kanë të drejtë në hisen e tyre

Lokacioni i Organizatës: Viti

Lokacioni i Projektit: Viti

Kohëzgjatja e projektit: 10 muaj

Fondet e projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit

Projekti "Gratë kanë të drejtë në hisen e tyre", ka për qëllim të rris nivelin e zbatimit të ligjit për barazi gjinore, nga ana e gjykatave dhe institucioneve komunale dhe zbatimin e të drejtave të grave për të trashëguar pasurinë e familjes si dhe të rris ndërgjegjësimin e grave që të kërkojnë të drejtat e garantuara me ligj. Elita do të monitoroj Gjykatën Themelore të Gjilanit dega në Viti dhe do të ndërmarr aktivitete ndërgjegjëse për gratë dhe të drejtën e tyre trashëgimore.

Përfituesi: Prehja

Titulli i Projektit: Qytetari më afër drejtësisë (II)

Lokacioni i Organizatës: Skenderaj

Lokacioni i Projektit: Skenderaj

Kohëzgjatja e projektit: 7 muaj

Fondet e projektit: US \$ 8,688

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit

Projekti "Qytetari më afër drejtësisë (II)", fokusohet në monitorimin e seancave gjyqësore mbi dhunën në familje në Gjykatën Themelore të Mitrovicës dega në Skenderaj. Përmes këtij projekti, Prehja ka për qëllim krijimin e një sistemi efektiv gjyqësor, ekzaminim dhe trajtimin e paanshëm në çështjet gjyqësore për të gjithë qytetarët e Skenderajt.

Përfituesi: AGRO - EKO

Titulli i Projektit: Gjykata efektive -

Drejtësi për qytetarët

Lokacioni i Organizatës: Gjilan

Lokacioni i Projektit: Gjilan

Kohëzgjatja e projektit: 8 muaj

Fondet e projektit: US \$ 8,600

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit

AGRO-EKO nëpërmjet këtij projekti ka për qëllim të monitoroj Gjykatën Themelore në Gjilan në lidhje me kryerjen e shkurorëzimeve dhe rastet e kujdestarisë së fëmijëve si dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, në parimin e vlerave, standardeve dhe përgjegjësisë etike mbi të cilat bazohet puna e gjykatave dhe Qendrave për punë sociale për të raportuar, si dhe të ndihmoj dhe të sensibilizoj palët relevante të interesit dhe publikun (qytetarët dhe institucionet).

Përfituesi: Rrjeti i Lëvizjes për Paqe - NOPM

Titulli i Projektit: Monitorimi i përshtatshmërisë gjuhësore, pronës dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së komuniteteve jo-shumicë në sistemin e drejtësisë

Lokacioni i Organizatës: Kamenicë

Lokacioni i Projektit: Kamenicë

Kohëzgjatja e projektit: 7 muaj

Fondet e projektit: US \$ 8,500

ronësore ligjore, me fokus në komunitetet jo-shumicë.

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit

Projekti “Monitorimi i përshtatshmërisë gjuhësore, pronës dhe përmirësimi i pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë në sistemin e drejtësisë” fokusohet në monitorimin e Gjykatës Themelore të Gjilanit dega në Kamenicë në përshtatshmërinë e gjuhës dhe zbatimin e të drejtave pronësore ligjore, me fokus në komunitetet joshumicë.

Përfituesi: Qendra e avokimit për kulturë demokratike (ACDC)

Titulli i Projektit: Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë në rajonin e Mitrovicës

Lokacioni i Organizatës: Mitrovicë e veriut

Lokacioni i Projektit: Mitrovicë e veriut/ Vushtrri

Kohëzgjatja e projektit: 6 muaj

Fondet e projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit

Qëllimi i projektit është ngritja e vetëdijes dhe pjesëmarrja e qytetarëve në veri të Kosovës në sistemin e drejtësisë, përmes një programi që do të përfshij bashkëpunimin dhe krijimin e sinergjisë së palëve me interes. ACDC do të monitoroj punën e Gjykatës Themelore të Mitrovicës, për lëndë të caktuara si rastet ndëretnike, rastet e paraburgimit dhe rastet që përfshijnë gratë dhe të miturit.

Përfituesi: Shoqata e Intelektualëve të Pavarur (SHIP)

Titulli i projektit: Monitorimi i degës së Gjykatës Themelore-Deçan

Lokacioni i organizatës: Deçan

Lokacioni i projektit: Deçan

Kohëzgjatja e projektit: 7 muaj

Fondet e projektit: US \$ 8,500

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit

Projekti “Monitorimi i degës së Gjykatës Themelore-Deçan” fokusohet në qytetarët që ngrisin çështje në lidhje me Gjykatën Themelore të Pejës, dega në Deçan, përmes monitorimit të performancës së punës së kësaj gjykate, në lidhje me trajtimin, vendimet dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që kanë të bëjnë me prirjen e paligjshme të pyjeve.

Përfituesi: Lisi

Titulli i projektit: Drejtësi për të gjithë qytetarët

Lokacioni i organizatës: Shtërpce

Lokacioni i projektit: Shtërpce

Kohëzgjatja e projektit: 9 muaj

Fondet e projektit: US \$ 8,500

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit

Projekti “Drejtësi për të gjithë qytetarët” fokusohet në monitorimin e Gjykatës Themelore të Ferizajt dega në Shtërpce, sa i përket komunikimit me qytetarët dhe palët në procedurë. Përmes këtij projekti, Lisi ka për qëllim të ofroj mbështetje për qytetarët e Shtërpçës dhe fshatrave të kësaj komune, duke inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në seancat gjyqësore si dhe të rris transparencën e performancës së gjykatës së Shtërpçës.

Përfituesi: Qendra për Politika dhe Avokim (QPA)

Titulli i projektit: Për gjyqësor më transparent

Lokacioni i organizatës: Prishtinë

Lokacioni i projektit: Rahovec dhe Klinë

Kohëzgjatja e projektit: 7 muaj

Fondet e projektit: US \$ 9,900

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit

Projekti “Për gjyqësor më transparent” fokusohet në monitorimin e degës së gjykatës themelore të Prizrenit në Rahovec dhe degës së gjykatës themelore të Pejës në Klinë, në lidhje me rastet e degradimit mjedisor, me një fokus në degradimin e lumit Drini i Bardhë. QPA ka për qëllim të forcoj sundimin e ligjit dhe të rris besimin e qytetarëve në sistemin gjyqësor në Kosovë.

Projektet për ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut që synojnë luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës dhe korrektësisë në mesin e institucioneve të sektorit të drejtësisë në Kosovë:

Përfituesi: Emancipimi Civil Ma Ndryshe

(EC Ma Ndryshe)

Titulli i projektit: Lidhja e komuniteteve me ofruesit e drejtësisë

Lokacioni i organizatës: Prizren

Lokacioni i projektit: Prizren

Kohëzgjatja e projektit: 9 muaj

Fondet e projektit: US \$ 17,000

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit
EC Ma Ndryshe, përmes këtij projekti ka për qëllim të hartoj mjetet dhe shërbimet, që do të kontribuojnë në krijimin e një hapësire, e cila do të lidh qytetarët me ofruesit e drejtësisë, duke rezultuar në pjesëmarrjen e përmirësuar të qytetarëve në sektorin e drejtësisë dhe rritjen e besimit në sistemin e drejtësisë, përmes zhvillimit të një strategji tre vjeçare të kualifikuar të informimit për gjykatën themelore në Prizren, të zhvilloj mostra të mjeteve të komunikimit për përdorim të gjykatës, fushatë mediale për informimin e qytetarëve në lidhje me projektin, të krijoj një faqe të Facebook-ut dhe Twitter-it për projektin, vizita edukative në gjykatë dhe takime publike me ofruesit e drejtësisë dhe qytetarët.

Përfituesi: Komunikimi për Zhvillim Social (KZhC)
Titulli i projektit: A ka drejtësi pas padrejtësisë?
Lokacioni i organizatës: Graçanicë
Lokacioni i projektit: Graçanicë, Ranillug, Partesh dhe Klllokot
Kohëzgjatja e projektit: 7 muaj
Fondet e projektit: US \$ 19,930

Përshkrim i shkurtër i Projekt Propozimit
Përmes projektit të KZhC-së, pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë në komunën e Graçanicës, Klllokotit, Ranillugut dhe Parteshit do të vetëdijësohen për rëndësinë e njohurive në lidhje me funksionimin e autoriteteve gjyqësore, do të informohen në lidhje me funksionimin e gjykatave dhe sistemin e vendimmarrjes brenda tyre si dhe mënyrën e ushtrimit të drejtave të tyre të garantuara me kushtetutë dhe përmirësimin e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet komunitetit - qeverisë lokale - autoriteteve gjyqësore - shoqërisë civile.

Përfituesi: Kosova në BE
Titulli i projektit: Ndërgjegjësimi i qytetarëve për Drejtësisë dhe Procesin e privatizimit në Kosovë
Lokacioni i organizatës: Prishtinë
Lokacioni i projektit: Prishtinë, në tërë Kosovën
Kohëzgjatja e projektit: 10 muaj
Fondet e projektit: US \$ 17,000

Përshkrim i shkurtër i Propozim Projektit
Projekti “Ndërgjegjësimi i qytetarëve për Drejtësisë dhe procesin e Privatizimit në Kosovë” fokusohet në rritjen e qasjes të punonjësve të ndërmarrjeve të Kosovës në pronësi shoqërore dhe palëve të tjera të interesit në procesin e privatizimit në sistemin gjyqësor, përkatësisht në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, lidhur me përfitimet, kontestimet dhe zbatimin e të drejtave të tyre ligjore, të garantuara me ligj dhe të zbatuara nga Dhoma e Posaçme e Gjykatave Supreme.

RUNDI III

Projektet e monitorimit të gjykatave, që kanë për qëllim përmirësimin e marrëdhënieve gjykatë-komunitet:

Emri i Përfituesit të Grantit: Advocacy Center for Democratic Culture - ACDC
Titulli i Projektit: Monitorimi dhe Raportimi për punën e Gjykatës Themelore të Mitrovicës
Lokacioni i Organizatës: Mitrovicë veriore
Lokacioni i Projektit: Mitrovicë veriore
Kohëzgjatja e Projektit: 6 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
Qëllimi i projektit është ngritja e vetëdijes dhe pjesëmarrja e qytetarëve në veri të Kosovës në sistemin e drejtësisë, përmes një programi që do të përfshij bashkëpunimin dhe krijimin e sinergjisë së palëve me interes. ACDC do të monitoroj punën e Gjykatës Themelore të Mitrovicës për lëndë të caktuara, si rastet ndëretnike, rastet e paraburgimit dhe rastet që përfshijnë gratë dhe të miturit.

Emri i Përfituesit të Grantit: Iniciativa për progress - INPO
Titulli i Projektit: Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe pjesëmarrja në sistemin e drejtësisë
Lokacioni i Organizatës: Ferizaj
Lokacioni i Projektit: Ferizaj, Kaçanik and Shtërpce
Kohëzgjatja e Projektit: 6 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,785



Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
 Qëllimi i projektit është të përmirësoj të kuptuarit dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në sistemin e drejtësisë në regionin e Ferizajit, për të siguruar se sistemi gjyqësor është efikas, duke iu lejuar viktimave të dhunës dhe publikut të gjerë liri të qasjes së shërbimeve. Projekti fokusohet në vëzhgimin sistematik të funksionimit dhe procedurave të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe degëve të saj në Kaçanik dhe Shtërpce.

Emri i Përfituesit të Grantit: Femrat aktive të Gjakovës - FAGJ

Titulli i Projektit: Monitorimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, në lëmin e të drejtës familjare

Lokacioni i Organizatës: Gjakovë

Lokacioni i Projektit: Gjakovë

Kohëzgjatja e Projektit: 7 muaj

Fondet e Projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
 Projekti fokusohet në monitorimin e seancave gjyqësore në Gjykatën Themelore në Gjakovë, në lëmin e të drejtës Familjare. FAGJ synon të analizoj dispozitat ligjore dhe të monitoroj zbatimin e Ligjit mbi Familjen, duke kontribuar në mbrojtjen dhe re spektimin e të drejtave të grave dhe nevojën për rrit

jen e efektivitetit dhe përmirësimin e cilësisë së përfaqësimit në gjykatë.

Emri i Përfituesit të Grantit: Qendra për Politika dhe Avokim - QPA

Titulli i Projektit: Për Gjyqësi më transparente

Lokacioni i Organizatës: Prishtinë

Lokacioni i Projektit: Gjakovë, Klinë dhe Rahovec

Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj

Fondet e Projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
 Qëllimi kryesor i projektit është të kemi Gjyqësor efikas, të drejtë dhe të paanshëm si dhe rritje të besimit të qytetarëve ndaj punës së gjyqësorit. QPA do të monitoroj punën e Gjykatës Themelore në Gjakovë, Gjykatës Themelore të Pejës dega në Klinë dhe Gjykatës Themelore të Gjakovës dega në Rahovec, duke i kushtuar kujdes të veçantë lëndëve penale nga neni 347 i kodit penal: ndotja, shkatërrimi dhe degradimi i mjedisit, duke u fokusuar në lëndët penale të degradimit të shtratit të lumenjve të Gjakovës, Klinës dhe Rahovecit.

Emri i Përfituesit të Grantit: AGRO - EKO
Titulli i Projektit: Drejtësi për qytetarët
Lokacioni i Organizatës: Gjilan
Lokacioni i Projektit: Gjilan
Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,000

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
Përmes këtij projekti Agro-Eko synon të rris efikasitetin e Gjykatës Themelore të Gjilanit, për trajtimin dhe prioritarizimin e lëndëve për vepra kundër dhunës në familje dhe shkurorëzimit. Agro-eko do të monitoroj Gjykatën Themelore në Gjilan në rastet e dhunës në familje dhe shkurorëzimit.

Emri i Përfituesit të Grantit: Elita
Titulli i Projektit: Bashkë mbrojmë pyjet
Lokacioni i Organizatës: Viti
Lokacioni i Projektit: Viti
Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,040

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
Projekti fokusohet në monitorimin e aktiviteteve të Gjykatës Themelore të Gjilanit dega në Viti, në pranimin, procedimin shqyrtimin dhe ekzekutimin e lëndëve që kanë të bëjnë me dëmtimin e pyjeve, monitorimin e punës së policisë së Kosovës në ekzekutimin e lëndëve që kanë të bëjnë me dëmtimin e pyjeve, si dhe monitorimin e punës së ekonomisë së pyjeve në shqiptimin e fletëparaqitjeve në gjykatë për dëmtim të pyjeve.

Emri i Përfituesit të Grantit: Qendra për integritet dhe zhvillim në Dragash
Titulli i Projektit: Për një gjykatë transparente dhe të përgjegjshme
Lokacioni i Organizatës: Dragash
Lokacioni i Projektit: Dragash
Kohëzgjatja e Projektit: 7 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 7,690

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
Projekti fokusohet në monitorimin e Gjykatës Themelore në Prizren dega në Dragash, për

përgjegjshmërinë dhe transparencën në lidhje me keqpërdorimet zgjedhore, luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës në institucionet gjyqësore.

Emri i Përfituesit të Grantit: Polis
Titulli i Projektit: Drejtësia me qasje qytetare në shërbim të gjyqësisë së drejtë III
Lokacioni i Organizatës: Lipjan
Lokacioni i Projektit: Lipjan
Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,500

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
Synimi i përgjithshëm i projektit konsiston në forcimin e partneritetit të mirëbesueshëm në mes qytetarit dhe gjykatës, përmes mbikëqyrjes qytetare, pjesëmarrjes së qytetarëve në seanca gjyqësore, për të zhvilluar një proces gjyqësor më efektiv, efikas, transparent dhe llogaridhënës për publikun. Projekti fokusohet në monitorimin e Gjykatës themelore të Prishtinës, dega në Lipjan, për rastet që përfshijnë gratë dhe minoritetet.

Emri i Përfituesit të Grantit: Partners-Kosova, Qendra për menaxhimin e konfliktit
Titulli i Projektit: Monitorimi i gjykatave rreth referimit të lëndëve civile për ndërmjetësim
Lokacioni i Organizatës: Prishtinë
Lokacioni i Projektit: Prishtinë, Ferizaj, Gjakovë and Mitrovicë
Kohëzgjatja e Projektit: 7 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 9,885

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
Partners Kosova, përmes këtij projekti, synon të rris transparencën e gjykatave dhe prokurorive, përmes monitorimit të lëndëve civile të referuara nga gjykatat dhe prokuroritë për ndërmjetësim. Projekti fokusohet në monitorimin e procesit të referimit të lëndëve civile nga gjykatat themelore dhe prokuroritë në qendrat për ndërmjetësim në secilën qendër dhe monitorimin e lëndëve të cilat kthehen nga qendrat për ndërmjetësim, qoftë të zgjidhura apo të pa zgjidhura.



Emri i Përfituesit të Grantit: Shoqata e Intelektualëve të Pavarur-SHIP
 Titulli i Projektit: Monitorimi i Gjykatës Themelore, dega Deçan-II
 Lokacioni i Organizatës: Deçan
 Lokacioni i Projektit: Deçan
 Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj
 Fondet e Projektit: US \$ 9,000

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
 Qëllimi i projektit është forcimi i sistemit të drejtësisë, profesionalizimi dhe marrja e vendimeve në baza të duhura ligjore dhe profesionale. Projekti ka të bëjë me ngritjen e shqetësimeve të qytetarëve rreth institucioneve të drejtësisë, përafrimin e tyre me këto institucione si dhe rritjen e performancës së gjykatave të Kosovës.

Projektet për ndërgjegjësimin dhe informimin e publikut që synojnë luftën kundër korrupsionit dhe

rritjen e transparencës dhe korrektësisë në mesin e institucioneve të sektorit të drejtësisë në Kosovë:

Emri i Përfituesit të Grantit: Future without Fear - FWF
 Titulli i Projektit: Drejtësia është e arritshme
 Lokacioni i Organizatës: Shtërpce
 Lokacioni i Projektit: Shtërpce
 Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj
 Fondet e Projektit: US \$ 12,392

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
 Qëllimi i këtij projekti është që qytetarët e komunës së Shtërpçës të jenë më të vetëdijshëm se si vepron sistemi gjyqësor në Kosovë, si të ushtrojnë të drejtat e tyre dhe si ata mund të kontribuojnë në funksionimin më të mirë të sistemit gjyqësor.

Emri i Përfituesit të Grantit: PREHJA
Titulli i Projektit: Çka është e huaja nuk bëhet e jotja
Lokacioni i Organizatës: Skenderaj
Lokacioni i Projektit: Skenderaj
Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 17,126

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
Kjo fushatë synon të krijoj mirëkuptimin ndërmjet burrave dhe grave për barazi gjinore në secilin aspekt të jetës, veçmas për trashëgimi në pronë, vetëdijësimin e gjinisë mashkullore për të drejta të barabarta, vetëdijësimin e femrave për t'i kërkuar dhe vënë në zbatim të drejtat e garantuara dhe qasje në drejtësi.

Emri i Përfituesit të Grantit: Center for development of local communities - CDLC
Titulli i Projektit: Të drejtat e qytetarëve dhe sistemit gjyqësor në Kosovë
Lokacioni i Organizatës: Mitrovicë veriore
Lokacioni i Projektit: Mitrovicë veriore
Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 18,684

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
Qëllimi i përgjithshëm i projektit është që të rris ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe pjesëmarrjen në sistemin e drejtësisë dhe gjykatën në Mitrovicën e Veriut. Projekti do t'i ndihmoj qytetarët të informohen për punën dhe funksionimin e gjykatave si dhe mundësinë për të realizuar të drejtat e tyre.

Emri i Përfituesit të Grantit: Syri i Vizionit
Titulli i Projektit: Mbroje pronën tënde
Lokacioni i Organizatës: Pejë
Lokacioni i Projektit: Pejë, Deçan, Klinë dhe Istog
Kohëzgjatja e Projektit: 8 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 18,684

Përshkrim i shkurtër i projekt propozimit
Projekti synon të ngris vetëdijen e qytetarëve mbi rëndësinë e zgjidhjes së çështjeve të pronës, si në kuptim të bartjes së trashëgimisë tek trashëguesit përkatës të saj, ashtu edhe në raport me ndërrimin e pronarëve, duke e shoqëruar me dokumentacionin e duhur, duke u fokusuar kryesisht në zonat rurale dhe aty ku mungon vetëdija dhe praktikat e tilla.

Emri i Përfituesit të Grantit: Qendra Kosovare për avokim dhe zhvillim - KADC
Titulli i Projektit: Aktivizmi qytetar për një sistem transparent të drejtësisë
Lokacioni i Organizatës: Prishtinë
Lokacioni i Projektit: Prishtinë, në tërë Kosovën
Kohëzgjatja e Projektit: 6 muaj
Fondet e Projektit: US \$ 18,684

Përshkrim i shkurtër i projektit propozimit
Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të kontribuoj në përmirësimin e perceptimit të popullatës në sistemin e drejtësisë në Kosovë, në lidhje me të drejtat e konsumatorit. Projekti fokusohet në ngritjen e vetëdijes së popullatës për të drejtat e tyre si konsumator dhe rolin e tyre në arritjen e transparencës në sistemin e drejtësisë.

Me qëllim të arritjes së ndikimit maksimal, ATRC i ka ofruar secilit përfitues të grantit shërbime për zhvillimin e kapaciteteve, përmes burimeve të brendshme dhe të jashtme, ashtu që të gjithë përfituesit e grantit të zbatojnë me sukses projektet e tyre. Gjatë këtij viti, ATRC ka organizuar dy takime dhe një tryezë të rrumbullakët në mes organizatave përfituese të granteve dhe përfaqësuesve të institucioneve gjyqësore të Kosovës dhe dy punëtori për organizatat përfituese të granteve.

VAZHDON BASHKËPUNIMI NË MES INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË SË KOSOVËS DHE ORGANIZATAVE LOKALE



Më 7 mars ATRC organizoi takimin e parë në mes të përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë dhe organizatave përfituese të granteve për projektin e USAID /ATRC "Rritja e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë". Qëllimi i takimit ishte të sjell së bashku përfaqësuesit e institucioneve gjyqësore të Kosovës dhe të organizatave lokale në ndarjen e informatave në lidhje me infrastrukturën ligjore të gjykatës, ligjin e ri për gjykatat, qasjen në sistemin e gjykatave, mekanizmat ligjor në dispozicion për monitorimin e gjykatave dhe praktikat më të mira të komunikimit me gjykatat. Gjithashtu, organizatat përfituese të granteve kanë patur mundësi t'i prezantojnë projektet e tyre para përfaqësuesve të institucioneve të

drejtësisë.

Takimi u vlerësua pozitivisht si nga institucionet gjyqësore të Kosovës ashtu edhe përfaqësuesit e organizatave përfituese të granteve. Mendimi i përgjithshëm ishte se kjo ishte mundësi e rrallë për të dy sektorët për të përmbushur dhe të ndajnë idetë e tyre për përmirësimin e Sistemit Gjyqësor në Kosovë. Të pranishëm nga institucionet e drejtësisë në këtë takim ishin: Hydajet Hyseni (Këshilli Gjyqësor i Kosovës), Sadri Krasniqi (Këshilli Prokurorial i Kosovës), Zef Prensrecaj (Zyra e Prokurorit Disiplinor) dhe përfaqësues të 12 USAID/ATRC organizatave përfituese të granteve të runderit të II-të.

INFORMIMI MBI TË GJETURAT E MONITORIMIT TË GJYKATAVE



Më 26 qershor ATRC organizoi punëtorinë “Informimi mbi të gjeturat e monitorimit të Gjykatave”, në mes të përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë dhe 12 organizatave lokale përfituese të granteve të rundit të dytë në kuadër të projektit “Rritja e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë”, të mbështetur nga USAID dhe implementuar nga ATRC.

Qëllimi i organizimit të punëtorisë ishte që 12 organizatat lokale përfituese të këtij projekti të paraqesin të gjeturat preliminare, rezultatet si edhe vështirësitë gjatë implementimit të projekteve të tyre përballë përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë.

Fjala hyrëse e kësaj punëtorie u bë nga z. Randall Olson Zëvendës Drejtor i DG në USAID, ku në mes të tjerash ai tha se “Çelësi për qasje efektive dhe transparente në sistemin e drejtësisë në Kosovë është

bashkëpunimi në mes të sektorit të drejtësisë dhe shoqërisë civile”.

Diskutimi u zhvillua në mes të përfaqësuesve të organizatave lokale dhe përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë: Hydajet Hyseni (Këshilli Gjyqësor i Kosovës), Sadri Krasniqi (Këshilli Prokurorial i Kosovës), Zef Prendrecaj (Zyra e Prokurorimit Disiplinor). Hydajet Hyseni theksoj se “Ky bashkëpunim e ndihmon KGJK-në që ta përmirësojë punën e gjyqësorit në ofrim të drejtësisë për Kosovën”.

Kjo punëtori për ATRC-në ishte një mundësi e mirë për t’u shkëmbyer informata me rëndësi, të cilat do të përdoren si mjete avokuese gjatë implementimit të projektit për të arritur rezultate të qëndrueshme.



PUNËTORI “MANUALI I POLITIKAVE OPERACIONALE DHE FINANCIARE TË ORGANIZATËS”

Më 3 shtator ATRC ka mbajtur punëtorinë “Manuali i politikave operacionale dhe financiare të organizatës”, për 12 organizatat lokale përfituese të granteve të rundit të dytë në kuadër të projektit “Rritja e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë”, të mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar USAID dhe implementuar nga ATRC.

Kjo punëtori është mbajtur si pjesë e asistencës teknike që ATRC ofron përfituesve të granteve USAID/ ATRC për ngritjen e kapaciteteve të tyre. Pritet që përfituesit e granteve që nuk kanë politika të organizatës t’i hartojnë ato deri në fund të projektit.

PREZANTIMI I REZULTATEVE TË PROJEKTIT DHE GJETJEVE PËRFUNDIMTARE NGA AKTIVITETET E MONITORIMIT TË GJYKATAVE DHE VETËDIJËSIMIT PUBLIK

Më 3 tetor në Prishtinë, u mbajt tryeza e rrumbullakët “Prezantimi i rezultateve të projektit dhe gjetjeve përfundimtare nga aktivitetet e monitorimit të gjykatave dhe vetëdijesimit publik”, në kuadër të projektit “Rritja e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë”, i cili mbështetet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe implementohet nga ATRC.

Qëllimi tryezë ishte që organizatat lokale, që janë shpërblyer nga ky projekt, t’i prezantojnë para përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë gjetjet përfundimtare nga monitorimi i gjykatave gjithandej Kosovës si dhe rezultatet që janë arritur gjatë realizimit të projekteve të tyre. Gjashtë organizata vendore, nga gjithsej 12 përfituese të rundit të dytë të granteve: Advocacy Center for Democratic Culture (ACDC), nga Mitrovica Veriore, Shoqata e Intelektualëve të Pavarur (SHIP), nga Deçani, PREHJA, nga Skenderaj, Qendra për Politika dhe Avokim (QPA), nga Prishtina, Komunikacija za Razvoj Društva (CSD), nga Gracanica dhe Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe), nga Prizreni, u përqendruan në prezantimin e rezultateve dhe të gjeturave në: rastet e trashëgimisë me fokus tek gratë, dhunës në familje përkitazi me të drejtat e grave dhe fëmijëve, prerjes së pyjeve dhe degradimit të natyrës, komunikimit midis gjykatave dhe qytetarëve, shkallës së marrjes parasysh të të drejtave të komuniteteve jo shumicë nga gjykatat, respektimit të të drejtave të punëtorëve gjatë procesit të privatizimit, etj.

Përveç përfaqësuesve të organizatave lokale, prezent në këtë tryezë ishin edhe përfaqësues të lartë nga institucionet e drejtësisë së Kosovës: justice instiz. Enver Peci, Kryetar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), z. Hydajet Hyseni nga Këshilli Gjyqësor i

Kosovës (KGJK), z. Sadri Krasniqi nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe z. Zef Prendrecaj nga Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD) si dhe përfaqësuesi i lartë nga USAID, z. Randal Olson.

Në mesin e shumë diskutimeve, z.Enver Peci, Kryetari i KGJK-së tha se çmon lartë kontributin e organizatave vendore në përpjekjen e përmirësimit të punës së gjyqësorit. Kjo ndihmon në drejtim të rritjes së transparencës dhe rritjes së besimit ndaj qytetarëve. Ai veçoi kontributin e organizatës vendore nga Mitrovica e Veriut, që po bën përpjekje në inkuadrimin e qytetarëve serb në sistemin juridik të Kosovës, që është edhe prioritet i KGJK-së.

Ndërsa, z. Randal Olson nga USAID-i tha se është i impresionuar me zhvillimet pozitive që po ndodhin në sektorin e drejtësisë në Kosovë, duke shtuar se ky takim është një shembull i mirë i vazhdimit dhe rritjes së bashkëpunimit në mes të këtij sektori dhe shoqërisë civile të Kosovës.

Në fund, drejtori i ATRC, z. Kushtrim Kaloshi tha se përmirësimi i sistemit të drejtësisë është jo vetëm projekt, por edhe misioni ynë.

TAKIM NË MES TË PËRFAQËSUESVE TË INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË DHE 15 ORGANIZATAVE LOKALE

Më 19 dhjetor ATRC mbajti takimin në mes të përfaqësuesve të institucioneve të drejtësisë dhe 15 organizatave lokale, të cilat janë të angazhuara në monitorimin e gjykatave dhe edukimin e publikut për qasje në drejtësi, në kuadër të projektit: “Rritja e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në Sistemin e Drejtësisë”, i cili financohet nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe implementohet nga ATRC.

Ky takim u mbajt në kuadër të takimeve të rregullta

në mes të akterëve të projektit, e që për qëllim kanë të rrisin bashkëpunimin në mes të institucioneve të drejtësisë dhe qytetarëve të Kosovës. Përfaqësuesit e institucioneve të drejtësisë i konsiderojnë këto takime të dobishme, sepse ata kanë mundësi që për së afërmi të njihen me bregat e qytetarëve për sistemin e drejtësisë. Poashtu, përfaqësuesit e organizatave lokale e shohin këtë një mundësi të mirë, pasi kanë mundësi që direkt t’i raportojnë të gjeturat gjatë punës së tyre në monitorimin gjykatave.



PROGRAMI PËR AVOKIM

Për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në zhvillimin e institucioneve dhe praktikave demokratike ATRC, në partneritet me organizata tjera dhe e vetme, në vazhdimësi inicion fushata avokimi në nivel lokal dhe nacional, duke synuar që problemet e indentifikuara në komunitete t'i kthej në çështje të forta avokimi dhe si rezultat t'i gjej zgjidhjen e merituar. Programi për avokim gjithashtu siguron një platformë për rrjetëzim, shkëmbim informatash dhe aktivizim me OJQ-të tjera nga Kosova dhe rajoni.

Gjatë vitit 2014, ATRC ka qenë e përfshirë në këto projekte:

- Drejtësia dhe qytetarët
- Qytetarë aktiv-Komuna të përgjegjshme dhe transparente
- Monitorimi i procesit të kthimit të zhvendosurve nga vendet e treta
- Politika energjetike të qëndrueshme në Evropën Juglindore (SEE SEP)
- Development of the ENV.Net in West Balkan and Turkey: Giving Citizens Voice
- Promovimi i diversitetit kulturor në Kosovë

"Bringing out the

advocate in everyone"





DREJTËSIA DHE QYTETARËT

Kampanja “Drejtësia dhe qytetarët”, financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit - Zyra ndërkombëtare e Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit, është një lëvizje që sjell së bashku qytetarët dhe grupet e shoqërisë civile me qëllim të identifikimit të çështjeve konkrete në sistemin e drejtësisë dhe promovimin e ndryshimeve përmes avokimit publik. Qëllimi i kampanjës është që të promovojmë një qeveri më të përgjegjshme dhe të rrisim përgjegjshmërinë e sistemit të drejtësisë ndaj nevojave të qytetarëve.

Gjatë dy viteve të fundit, Kampanja ka punuar ngushtë me Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK) për të konsideruar marrjen e hapave lidhur me promovimin e qasjes më të lehtë në procedurat e ankesave të IPK-së si dhe ka rekomanduar vendosjen e kutive të ankesave si një mënyrë për të zgjeruar shtrirjen e IPK-së tek të gjithë qytetarët e Kosovës. Këtë vit Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) ka marrë parasysh rekomandimet për të vendosur kutitë e ankesave nga zyrat komunale. Këto kuti do t’ju lehtësojnë qytetarëve që të ankohen kundër zyrtarëve të policisë pa shkuar në zyrën e IPK-së dhe pa frikën e mundshme për të parashtruar një ankesë të tillë në stacionet e policisë. Qytetarët tani mund të parashtrorjnë ankesa kundër zyrtarëve të policisë përmes kutive të ankesave në zyrat e regjistrimit të gjendjes civile, personalisht në zyrën e IPK-së, me telefon, me e-mail, dhe përmes faqes së internetit të IPK-së dhe faqet e Facebook.

Kampanja gjithashtu, ka punuar ngushtë me zyrtarë të sistemit të drejtësisë për të promovuar qasjen e qytetarëve në mekanizmat e ankesave dhe mbikëqyrjes, si një hap i rëndësishëm në promovimin e transparencës dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Proceset efektive të ankesave sigurojnë që zyrtarët të mbahen përgjegjës kur ata shkelin të drejtat e qytetarëve. Kampanja ka punuar edhe me Zyrën e Prokurorit Disiplinor për të avokuar lidhur me përmirësimin e qasjes së qytetarëve në proceset e ankesave kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe me Odën e Avokatëve të Kosovës për të përmirësuar qasjen në pro-

ceset e ankesave kundër avokatëve.

Aktivitet tjetër i Kampanjës ishte inicimi i nismës legislative, duke mbledhur mbi 10 000 nënshkrime në mbështetje të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, e cila kishte për qëllim që të lejoj kompensimin e drejtë për shkelje të të drejtave të njeriut të kryera nga shteti, duke përfshirë dëmet ekonomike dhe jo-ekonomike.

Kampanja ka përgaditur edhe një seri videosh për informimin e publikut për të drejtat e tyre në sistemin e drejtësisë. Videot, me titull “Drejtësi n’Shpejtësi”, trajtojnë çështje të tilla si: Të drejtat e viktimave të krimit, Ankesat ndaj Institucionit të Ombudspersonit, Të drejtat e të paraburgosurve; Të drejtat e Palëve të Akuzuara; Të drejtat e viktimave të dhunës në familje; E Drejta për të marrë ndihmë ligjore; Ankesat e qytetarëve ndaj Zyrtarëve të Policisë; Ankesat e qytetarëve ndaj gjykatësve dhe prokurorëve; Ankesat e qytetarëve kundër Avokatëve dhe Ankesat e qytetarëve kundër zyrtarëve të EULEX-it. Në çdo video paraqitet një zyrtar duke dhënë informacione lidhur me qëllimin e institucionit në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Videot janë transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës (RTK), përgjatë Kupës së Botërorit dhe gjatë orëve të shikueshmërisë së lartë, duke siguruar që nëpërmjet tyre të arrihet një audiencë e gjerë.

Kampanja Drejtësia dhe Qytetarët, e koordinuar nga ATRC, ka mbajtur edhe 2 trajnime për avokim dhe 16 punëtori për Edukim të Publikut, në komunat: Ferizaj, Gjiilan, Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Viti, Deçan, Lipjan, Kamenicë, FushëKosovë, Obiliq, Istog dhe Prishtinë. Qëllimi i punëtorive ishte t’u ofrohet qytetarëve dhe të rinjëve të qendrave rinore mundësia të mësojnë më shumë për Të Drejtat e Viktimave të Krimit në Sistemin e Drejtësisë. Gjatë punëtorive qytetarët patën mundësi të parashtrorjnë pyetje, të përfshihen në diskutime me zyrtarët për shqetësimet e tyre, përvojat dhe të ndajnë mendimet për temën e Të Drejtave të Viktimave të Krimit.

NISMË LEGJISLATIVE DUKE NËNSHKRUAR PETICIONIN NË MBËSHTETJE TË NDRYSHIMIT TË LIGJIT MBI MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË

Qëllimi i kësaj iniciative është që të lejoj kompensimin e drejtë për shkelje të të drejtave të njeriut të kryera nga shteti, duke përfshirë dëmet ekonomike dhe jo-ekonomike. Kampanja propozon ndryshimin e nenit 69 të Ligjit për të lejuar kompensimin e dëmeve jo-ekonomike me rastin e shkeljes të të drejtave të njeriut të kryera nga shteti. Ligji aktualisht lejon vetëm riparimin e dëmeve ekonomike, të tilla si dëmtim të pronës dhe humbjen e pagave. Shpesh dëmet më të rëndësishme që rezultojnë nga shkelja e të drejtave të njeriut janë dhimbje dhe vuajtje, dëme të cilat janë jo-

ekonomike. Për të arritur këtë qëllim, Kampanja ka mbledhur mbi 10,000 nënshkrime në favor të amendamentit. Më 2 prill kampanja ka organizuar konferencë për media, me qëllim të paraqitjes së nismës legislative me mbi 10000 nënshkrime në Kuvendin e Kosovës.

TRYEZË E EKSPERTËVE

Më 18 Nëntor, Kampanja Drejtësia dhe Qytetarët organizoi tryezën për të diskutuar vështirësitë që qytetarët i hasin në qasje në transparencën dhe llogaridhënieën e mekanizmave të mirëfilltë disiplinor të sistemit të drejtësisë. Kjo tryezë solli së bashku rreth dyzet ekspertë, zyrtarë, përfaqësues të shoqërisë civile si dhe qytetarë. Qëllimet kryesore të tryezës ishin vlerësimi i qasjes, transparencës dhe pavarësisë së këtyre institucioneve, inkurajimi i diskutimeve lidhur me vështirësitë kryesore që i hasin qytetarët dhe që ndikojnë në besueshmërinë ndaj sistemit të drejtësisë si dhe të hartohen zgjidhje përkatëse që ndikojnë në ngritjen e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Fjala hyrëse e tryezës u mbajt nga Ambasadorja Tracey Ann Jacobson, e cila theksoi rëndësinë e qasjes, transparencës dhe pavarësisë së mekanizmave disiplinor në mënyrë që të funksionoj sistemi i drejtësisë.

Ajo ka vlerësuar përpjekjet e bëra nga institucionet për të lehtësuar qasje në mekanizmat e ankesave dhe ftoi zyrtarët që të ndërmarrin hapa të mëtutjeshëm për të promovuar institucione më të qasshme. Ngjashëm, Kryetari i Këshillit Gjyqësor, Enver Peci ka konkluduar se “besimi i qytetarëve ndaj sistemit të drejtësisë është jashtëzakonisht i rëndësishëm në një shoqëri demokratike. Sistemi gjyqësor duhet të jetë i lirë, i pavarur dhe pa paragjykime në aktet e tij dhe duhet të cilësohet si i tillë nga publiku”.

Kushtrim Kaloshi- Drejtori Ekzekutiv i ATRC, Ambasadorja Tracey Ann Jacobson dhe Enver Peci-Kryetari i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, gjatë fjalës së tyre hyrëse theksuan rëndësinë e transparencës dhe qasjes efektive gjatë proceseve disiplinore, duke iu ofruar qytetarëve një sektor të përgjegjshëm të drejtësisë

KËRKO DREJTËSI TRAŽI PRAVDU



Tryeza ishte e ndarë në dy panele. Paneli i parë adresoi temën e qasjes në proceset disiplinore kurse, paneli i dytë i tryezës analizoi pavarësinë e mekanizmeve disiplinor në sektorin e drejtësisë. Të dy panelet u përcollën me diskutime të hapura dhe sjellën rekomandime, të cilat do ta ndihmojnë Kampanjën për të identifikuar çështje konkrete për reforma të politikave përkatëse si dhe formulimin e strategjive për promovim të këtyre reformave. Tryeza pati një vëmendje mjaft të gjerë nga mediat, duke publikuar rreth 20 raportime, përfshirë televizionet, mediat online dhe ato të shtypit. Këto publikime të mediave i mbështetën gjetjet e tryezës dhe rekomandimet e Kampanjës Drejtësia dhe Qytetarët për një sistem të drejtësisë më të qasshëm, transparent dhe të përgjegjshëm.

Kampanja implementohet nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC), Qendra për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Regjional (CLARD), si dhe shoqëria e avokatëve Sejdiu & Qerkini, Sh. P. K., me ndihmën e Grupit për të Drejtën Ndërkombëtare Publike dhe Politikave (PILPG) dhe financuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së, Zyra Ndërkombëtare për Narkotik dhe Zbatim të Ligjit.



QYTETARË AKTIV - KOMUNA TË PËRGJEGJSHME DHE TRANSPARENTË

ATRC ka vazhduar implementimin e projektit “Qytetarë aktiv-komuna të përgjegjshme dhe transparente”, i cili financohet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme. Projekti synon të rris pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në komunat: Gjilan, Viti, Kamenicë dhe Novobërdë.

Këtë vit ATRC ka zhvilluar takime me Kryetarë të Komunave dhe anëtarë të Kuvendeve komunale, me qëllim të informimit të tyre rreth aktiviteteve të deritanishme të ATRC-së në këto komuna dhe sigurimit të përkrahjes së tyre për aktivitetet që do të zhvillohen në vazhdim. Projekti ka vazhduar me organizimin e 12 punëtorive me temë: Planifikimi kooperues dhe Qeverisja dhe Buxheti me pjesëmarrje për zyrtarë të komunave, anëtarë të kuvendeve komunale dhe

përfaqësues të shoqërisë civile. Punëtoritë kishin për qëllim informimin dhe diskutimin rreth mënyrave të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje në nivel lokal si dhe rëndësinë e themelimit të Komiteteve Konsultative. Gjatë punëtorive ATRC ka prezantuar edhe udhëzuesin “Buxheti me pjesëmarrje”, i cili përmban shembuj dhe rekomandime për komunat dhe organizatat e shoqërisë civile e qytetarët rreth buxhetimit me pjesëmarrje.



Gjatë identifikimit të nevojave dhe rekomandimeve të qytetarëve të katër komunave të regjionit të Gjilanit, gjatë vitit të kaluar, kërkesë e përbashkët e qytetarëve ka qenë themelimi i Komiteteve konsultative për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Prandaj, ATRC ka avokuar në secilin Komunë, për marrjen parasysh të kërkesave dhe rekomandimeve të qytetarëve dhe themelimin e këtij mekanizmi, i cili do të ndikonte te qytetarët dhe grupet tjera të interesit në procesin e vendimmarrjes për interes publik, i përcaktuar edhe me Udhëzimin administrativ për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve konsultative në komuna. Si rezultat i aktiviteteve avokuese Komuna e Vitisë dhe Kamenicës kanë themeluar Komitetin konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje, Komuna e Novobërdës ka themeluar Komitetin konsultativ të qytetarëve kurse, komuna e Gjilanit është në proces të themelimit të këtij komiteti. Themelimi i Komiteteve konsultative në komuna do të jenë një ofertë shtesë e qytetarëve, për t'i përfshirë edhe formalisht në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal dhe për të rritur transparencën, llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë, në anën tjetër.

Pas themelimit të Komitetit konsultativ, Komuna e Vitisë gjatë këtij viti ka filluar procesin e organizimit dhe funksionimit të këtij mekanizmi. Andaj, ATRC në bashkëpunim me Komunën e Vitisë ka organizuar dy takime me anëtarët e komitetit, me qëllim të diskutimit të rolit dhe rëndësisë së tyre në rritjen e pjesëmarrjes së

qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Gjatë takimit të parë anëtarët zgjodhën edhe strukturat udhëheqëse, kurse në takimin e dytë ATRC ka asistuar në përgaditjen e planit vjetor të aktiviteteve për vitin vijues, i cili i është përcjellur më pas Kuvendit të Komunës për aprovim.

Aktivitetet përmbyllës për këtë vit ka qenë konferenca regjionale, me qëllim të shkëmbimit të eksperiencave rreth aplikimit të praktikave dhe mënyrave për përfshirjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal. Kryetar dhe nënkryetar komunash, anëtarë të kuvendeve komunale, zyrtarë komunal dhe përfaqësues të shoqërisë civile pjesëmarrës të konferencës vlerësuan ATRC për organizimin e këtij aktiviteti, duke theksuar se ky ishte takimi i parë i organizuar në mes katër komunave. Ata u dakorduan që të vazhdohet me organizimin e takimeve të tilla, në mënyrë që komunat të diskutojnë dhe të gjejnë alternativa për zgjidhjen e çështjeve të përbashkëta.

ATRC gjatë vitit të ardhshëm do të vazhdojë implementimin e këtij projekti, duke u fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të Komiteteve konsultative në procesin e funksionimit të tyre. Rol të veçantë në këtë drejtim do t'i kushtohet ofrimit të asistencës direkte të Komiteteve konsultative në aplikimin e procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.

MONITORIMI I PROCESIT TË KTHIMIT TË TË ZHVENDOSURVE NGA VENDET E TRETA

Gjatë vitit 2014, ATRC ka vazhduar implementimin e projektit “Monitorimi i procesit të kthimit të të zhvendosurve nga Vendet e treta”, i cili financohet nga UNHCR. Projekti ka si objektiv monitorimin e procesit të kthimit të detyruar dhe vullnetar të azil kërkuesve Kosovar nga vendet e treta në Kosovë.

Përmes këtij projekti, ekipi monitorues i ATRC-së arrin të identifikoj të gjitha rastet, të cilat janë kthyer në mënyrë të detyruar apo vullnetare, duke përcjellur në vazhdimësi trendet e të kthyerve në Kosovë dhe qëndrueshmërinë e këtyre kthimeve.

Ekipi i monitoruesve të ATRC edhe gjatë vitit 2014 është vizituar nga përfaqësuesit e zyrës së UNHCR, të cilët shprehën interesin e tyre në lidhje me punën dhe angazhimet e stafit të ATRC në monitorimin e procesit të kthimit të të zhvendosurve në përgjithësi si dhe angazhimet dhe përkujdesjen që personat e kthyer marrin nga institucionet relevante pas kthimit në Kosovë në veçanti.

POLITIKA ENERGETIKE TË QËNDRUESHME NË EVOPËN JUG LINDORE (SEE SEP)

ATRC, në cilësinë e partnerit nacional për Kosovë, në bashkëpunim me SEE Change Net (Bosnjë), EDEN dhe Ekolëvizja (Shqipëri), CZSS dhe Public Interest Advocacy Center (Bosnjë), Society for Sustainable Development Design dhe Forum for Freedom Education (Kroaci), Association for Policy Research Analytica, Eko-Svest dhe Environmental Citizens' Association (Maqedoni), Green Home dhe MANS (Mali i Zi), Fractal dhe CEKOR (Serbi) ka vazhduar implementimin e projektit Politika Energjetike të Qëndrueshme në Evropën Juglindore (SEE SEP), i cili financohet nga Komisioni Evropian, UNDP dhe The Balkan Trust for Democracy. Projekti ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit në mes organizatave të shoqërisë civile dhe fuqizimin e qytetarëve për të ndikuar në politikat dhe praktikat për një sistem energjetik më të qëndrueshëm në Evropën Juglindore, një linjë me politikat dhe direktivat kyçe të BE.

ATRC në bashkëpunim me organizatat e gjashtë shteteve të rajonit synon krijimin e Modelit Energjetik të secilit shtet veç e veç, i cili më pas do t'i shërbej Qeverisë që mbi bazën e skenarëve të zhvilluar të hartoj strategji dhe plane afatgjate zhvillimi. Modeli energjetik i Kosovës do të jetë i ndarë në gjashtë sektorë, të cilët janë vlerësuar me më shumë ndikim në fushën e energjisë. Prandaj, ATRC gjatë këtij viti ka vazhduar me organizimin e takimeve konsultative me ekspertë të fushës së energjisë në Kosovë, duke u përqendruar në ndikimin e sektorit të nikelit, çimentos, transportit, energjisë së ripërtitshme dhe ofertës së tregut –Kapacitetet e Kosovës në energji të ripërtitshme në shpenzimin e energjisë elektrike. Këto aktivitete kanë për qëllim që të konsultohen ekspertët e fushave përkatëse në zhvillimin e Modelit të Energjisë së Kosovës.



Këtë vit rrjeti i organizatave të shoqërisë civile të Ballkanit Perëndimor: Rrjeti për Ndryshimin e Evropës Juglindore ka publikuar edhe raportin Fituesit dhe humbësit: Kush përfiton nga korrupsioni i nivelit të lartë në sektorin e energjisë në Evropën Juglindore?, ku konstatohet se dhjetëra miliona euro kanë humbur gjatë dekadave të fundit në shtatë vende të rajonit . Raporti u lansua më 24 qershor, 2014 në Bruksel, gjatë Konferencës së Politikave të Nivelit të Lartë , në kuadër të Javës së Energjisë së Qëndrueshme në BE 2014 , në të cilën morën pjesë edhe përfaqësuesit e ATRC. Organizatat në këtë konferencë kanë kërkuar nga institucionet e BE-së që të trajtojnë reformën e sektorit të energjisë në Evropën Juglindore si një prioritet urgjent. "BE-ja duhet t'i kushtoj vëmendje të veçantë ngjarjeve që janë duke ndodhur në sektorin e energjisë, duke përfshirë privatizimet dhe tenderimin e projekteve të reja si dhe t'i mbikëqyr planet e qeverisë për investime, të cilat shpesh nuk reflektojnë nevojat për një të ardhme të qëndrueshme të energjisë", ka thënë gjatë konferencës Garret Tankosić - Kelly, drejtori i SEE Change Net.

Bazuar në këtë raport ATRC dhe organizatat partnere në gjashtë shtetet e rajonit zhvilluan kampanja avokuese, me qëllim të vetëdijësimit të publikut të gjerë rreth korrupsionit në sektorin e energjisë në Evropën Juglindore. Në Kosovë kampanja ka filluar me shpërndarjen e raportit të organizatave ndërkombëtare, institucionet publike, agjencionet, organizatat e shoqërisë civile dhe Ambasada e Kosovës në Belgjikë, duke vazhduar më pas me mbajtjen e takimeve me përfaqësues të institucioneve, përgaditjen dhe emetimin e dy radio spoteve dhe organizimin e tryezës me përfaqësues të institucioneve, shoqërisë civile, ekspertë të energjisë dhe media.

KUSH PËRFITON NGA KORRUPSIONI I NIVELIT TË LARTË NË SEKTORIN E ENERGJISË NË EVROPËN JUGLINDORE

Më 4 korrik 2014, ATRC organizoi tryezën e rumbullakët me përfaqësues të institucioneve të Kosovës, shoqërisë civile, ekspertë të energjisë dhe media për të prezantuar të dalurat e raportit: Fituesit dhe humbësit: kush përfiton nga korrupsioni i nivelit të lartë në sektorin e energjisë në Evropën Juglindore?

Raporti përmban analizë të fenomenit të korrupsionit në sektorin e energjisë në vendet e Evropës Juglindore, efektet dhe pengesat që korrupsioni i ka sjellë vendeve përkatëse në proceset integruese evropiane, detyrat dhe obligimet që shtetet kanë në raport me BE-në në luftimin e fenomenit të korrupsionit, disa nga rastet korruptive më të përfolura dhe më të njohura në publik, të marra nga materialet të bëra publike të cilat janë hetuar apo kanë qenë raste në procedura gjyqësore në vendet e rajonit.

Në tryezë u tha se energjia është një nga segmentet më të mëdha në ekonominë e Evropës Juglindore, me

synime që të rritet edhe më shumë nëse planet ambicioze të qeverive të rajonit do të realizohen. Shtetet palë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë planifikojnë rreth 28.8 miliard euro investime në energji nga vitit 2012 deri në vitin 2020 në Ballkanin Perëndimor. Menaxhimi i këtyre investimeve do të jetë një sfidë ekzistenciale për shtetet e EJT-së.

Përvoja e deritashme, e theksuar në këtë raport edhe përmes rasteve konkrete, dëshmon se projektet në fushën e energjisë në rajon shpesh janë shënuar nga korrupsioni, i cili i ka larguar investitorët e njohur dhe ka ngritur shpenzimet. Gjithashtu, ka nënkuptuar mundësi të zvogëluara për zhvillim të qëndrueshëm të energjisë duke humbur burimet, duke ndikuar në tregje, duke e devijuar interesin publik drejt interesave private, duke e bazuar vendimmarrjen kundër kritereve racionale të qëndrueshmërisë dhe në favor të interesave personale.





Të pranishmit u pajtuan me konkluzionet se ndërtimi i një infrastrukture moderne të energjisë duhet të shkojë në vijë paralele me ndërtimin e shtetit ligjor, që nënkupton: luftimin e korrupsionit, zbatimin e ligjeve, konkurrencën e lirë, transparencën, informimin publik dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje etj.

Përvoja e Kroacisë, konkretisht hetimi, gjykimi dhe dënimi i ish Kryeministrin Ivo Sanader për pranimin e më shumë se 10 milion Eurove si ryshfet nga firmat në Hungari dhe Austri në fushën e energjisë, dëshmon më së miri për kriteret dhe kushtet strikte të BE-së në raport me vendet aspiruese për anëtarësim dhe në të njëjtën kohë dëshmon për sakrificat dhe veprimet konkrete të ndërmarra nga qeveria e Kroacisë në këtë rast.

Në raport janë përmendur disa raste më të përfolura dhe më të njohura në publik në gjithë rajonin, të cilat lidhen me korrupsionin në fushën e energjisë në përgjithësi dhe me projekte energjetike në veçanti, të dhënat e të cilave janë marrë nga materialet të bëra publike, ose të hetuar apo kanë qenë pjesë e padive, si:

Kosova, Rasti studimor 1: Rasti i shpifjeve lidhur me kontratën e KEK-ut

Në prill të vitit 2012 Arbana Xharra nga gazeta e pavarur ditore Zëri shkroi një artikull duke komentuar se afaristi Bejtush Zhugolli dhe dy vëllezërit e tij, janë

duke e mbështetur financiarisht fushatën zgjedhore të kryeministrin Thaçi dhe se në këmbim, ata fituan kontrata të majme në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Menjëherë pas publikimit të artikullit, Bejtush Zhugolli paditi Xharren dhe gazetën Zëri, megjithatë Xharra u shpall e pafajshme. Kur Selviqe Bajrami, një tjetër gazetare në Zëri, publikoi një raport për seancën e parë gjyqësore, Zhugolli e paditi edhe atë, por edhe ajo u shpall e pafajshme.

Kosova, Rasti studimor 2: Afera UNMIK/KEK

Një gjykatë gjermane dënoi Z. Jo Trutschler, menaxher i Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) në emër të UNMIK-ut, për shkelje të besimit dhe keqpërdorim të titullit akademik dhe e dënoi me tri vjet burg. Nga vitit 2000-2002 u zbulua se ai kishte marrë rreth 4.3 milionë dollarë (atëherë rreth 3.7 milion euro) dhe e kishte transferuar këtë shumë tek kompanitë fiktive në Gjibraltari. Hetuesit e OKB-së zbuluan se përveç kësaj Trutschler kishte falsifikuar diplomën e tij dhe kishte deklaruar përvojë më të madhe në menaxhim se sa ai kishte në të vërtetë. Shumica e parave u rikthyen.

Shqipëria, Rasti studimor 1: hetimi për pastrimin e parave

Rasti i Argita Berishës ka të bëj me blerjen e tokës në Shqipëri jo shumë kohë para se qeveria ta zgjedh atë si vendin e një projekti të energjisë, duke e rritur vlerën e saj. Avokati i blerësit ishte e bija e atëkohë kryeministrit Sali Berisha, ndërsa administratori i firmave vendore të blerësit ishte kunati i ish-Ministrit të Transportit, Lulzim Basha.

Shqipëria, Rasti studimor 2: Rasti i hidro-koncesionit

Shikuesit e televizionit shqiptar e panë një video-invizim të një kamere të fshehur e cila tregonte Ilir Metën, atëkohë zëvendës kryeministër, i cili mundohej që të korruptonte një koncesion të hidrocentraleve, duke nx-

itur një zemërim të gjerë. Ekspertët Amerikan dhe Britanik të forenzikës e konstatuan xhirimin si autentik, por gjykata e hodhi poshtë këtë për arsye procedurale dhe e caktoi ekspertin e vetë lokal, i cili konstatoi se incizimi ishte përpunuar. Ilir Meta gjithashtu është akuzuar për marrjen e rryshfetit prej 1 milion Euro për favorizimin e një biznesi në tenderin e naftës së papërpunuar. Në janar të vitit 2012, Gjykata e Lartë në Tiranë e liroi Ilir Metën për mungesë të provave.

Raportin e plotë mund ta shkarkoni në ueb faqen e ATRC në linkun:

http://www.advocacy-center.org/Newsletter/Publications/Fituesit_Humbesit.pdf

ULRIKE LUNACEK KËRKON ANGAZHIM TË SHTUAR TË GAZETARËVE NË LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

Në raportin e publikuar Fituesit dhe humbësit: kush përfiton nga korrupsioni i nivelit të lartë në sektorin e energjisë në Evropën Juglindore?, deputetja Lunaçek ka shkruar parathënien e këtij raporti. Zëvendës presidentja e Parlamentit Evropian, Ulrike Lunaçek ka kërkuar angazhim të shtuar të gazetarëve në luftimin e korrupsionit në sektorin e energjisë dhe në të njëjtën kohë ndalje të kërcënimeve dhe shantazheve ndaj punës së tyre hulumtuese. "Studimet e paraqitura në këtë raport tregojnë se frytet e investimit janë të mëdha, po kështu janë edhe tundimet", shkruan Lunaçek. Sipas Lunaçek "kjo tregon se korrupsioni i nivelit të lartë nuk njihet kufij dhe duhet luftuar seriozisht nga shtetet anëtare të BE-së si dhe nga vendet kandidatë". Për fat të keq, ashtu si tregojnë shumë raste të studimit, gazetarët që janë shumë të guximshëm për t'u përpjekur dhe përballur me figura të fuqishme në shoqëri të tilla, si

Brankica Stanković e Insajder B92 (Serbi), Arbana Xharra (Kosovë) dhe Leila Biçakçiq e Qendrës për Gazetari Hulumtuese (BeH), i janë nënshtruar presionit, kërcënimeve apo edhe padive gjyqësore, thjesht sepse janë përpjekur të vënë në dukje gabimet e bëra.

Lunaçek ka theksuar edhe rëndësinë e lejimit që gazetarët hulumtues të bëjnë punën e tyre pa pengesa. "BE-ja promovon lirinë e shprehjes në dialogun e saj me vendet e zgjerimit dhe mbështet përsosmërinë në gazetarinë hulumtuese, disa prej të cilave janë përfshirë në këtë raport. Kandidatët dhe kandidatët potencial për anëtarësim në BE duhet të sigurojnë që gazetarët mund ta bëjnë punën e tyre pa frikë nga dhuna dhe kërcënimet".

ZHVILLIMI I RRJETIT ENV.NET NË BALLKANIN PERENDIMOR DHE TURQI: TË FUQIZOHEN QYTETARËT

Në kuadër të aktiviteteve avokuese në nivel nacional ATRC, në cilësinë e partnerit nacional për Kosovë dhe në bashkëpunim me: Fondazione Punto.Sud (Itali), CO-PLAN (Shqipëri), EASD (Serbi), TEMA (Turqi), EEB (Belgjikë), është duke implementuar projektin regional: ENV.NET, i cili financohet nga Komisioni Evropian. Qëllimi kryesor i projektit është të fuqizoj kapacitetet e OJQ-ve në rajon, të mbështes aktivizmin civil, të fuqizoj qytetarët dhe të ndikoj në reformat e proceseve të përafritimit të standardeve të mjedisit.

Gjatë kësaj periudhe ATRC është angazhuar në aktivitete të ndryshme në Prishtinë dhe jashtë saj duke synuar që të edukojë qytetarët për rëndësinë e angazhimit të tyre të drejtpërdrejtë në aktivitetet mjedisore dhe të avokojnë në institucionet gjegjëse për zbatimin e Ligjeve dhe rregulloreve mjedisore.

Gjatë vitit 2014, ATRC ka organizuar dhe mbajtur një mori aktivitete në bashkëpunim të ngushtë me disa organizata lokale në komuna të Kosovës:

- janë organizuar katër punëtori në katër komuna të Kosovës: Deçan, Ferizaj, Podujevë dhe Kamenicë rreth temës “Menaxhimi i pyjeve dhe masat që merren në parandalimin e prerjeve ilegale”. Punëtoritë kishin si qëllim analizimin e gjendjes së pyjeve në komuna si dhe identifikimin e alternativave për parandalimin e prerjeve ilegale.

- Është organizuar një konferencë nacionale në Prishtinë me temën “Menaxhimi i pyjeve dhe masat që merren në parandalimin e prerjeve ilegale”. Tryeza mbledhi të gjithë akterët e përfshirë në mbrojtjen dhe menaxhimin e pyjeve, si: përfaqësues nga Komunitet i Kosovës, rojet e pyjeve, Agjencia Pyjore e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës etj, në një rën anë si dhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe media në anën tjetër, të cilët dhanë rekomandime për parandalimin e prerjeve ilegale dhe menaxhimin më të mirë të pyjeve.

- Është organizuar një trajnim dy ditor në Prishtinë për organizatat mjedisore, me temën: harmonizimi i legjislacionit nacional mjedisor me atë të BE-së dhe ngritja e fondeve.

- Janë organizuar tri tryeza të rrumbullakëta në tre Komuna të Kosovës: Prishtinë, Obiliq dhe Mitrovicë me temën: ndikimi i transportit në cilësinë e ajrit.

- Janë financuar katër projekte mjedisore në katër organizata lokale për të zhvilluar aktivitete sensibilizimi dhe presioni në çështje mjedisore.

MBROJTJA MJEDISORE DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE

ATRC dhe Instituti i Kërkimeve Urbane në Shqipëri janë duke zbatuar projektin “Mbrotjtja Mjedisore dhe Menaxhimi i Mbeturinave”, i cili mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian, përmes Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Shqipëri - Kosovë. Projekti implementohet në Komunën e Prizrenit dhe Bashkinë e Kukësit dhe fokusohet në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimi ekonomik, nëpërmjet promovimit të menaxhimit të integruar të mbeturinave, edukimit dhe trajnimit të komunitetit lokal dhe në veçanti të fëmijëve, për të mirat e kompostimit, që do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit në rajonin ndërkufitar Kosovë - Shqipëri.

Këtë vit, në kuadër të planit të aktiviteteve, ATRC

ka nënshkruar Marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Prizrenit dhe ka mbajtur trajnimin një ditë për Direktivat e BE-së në menaxhimin e mbeturinave, Legjislacioni dhe udhëzimet administrative për menaxhimin e mbeturinave në Kosovë dhe Ndikimi në mjedis i ndotjes nga plastika. Në këtë trajnim ishin të pranishëm zyrtarë të komunës së Prizrenit dhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët diskutuan dhe ndanë eksperiencat e tyre mbi temat e trajnimit. Për të ditur më mirë nivelin aktual të vetëdijes për menaxhimin e mbeturinave në rajonin e Prizrenit, ATRC ka bërë edhe një hulumtim në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin.

PROMOVIMI I DIVERSITETIT KULTUROR NË KOSOVË



ATRC ka vazhduar implementimin e projektit Promovimi i diversitetit kulturor në Kosovë, i cili financohet nga Këshilli i Evropës. Projekti ka për qëllim ngritjen e vetëdijes së publikut në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si dhe fuqizimin dhe ofrimin e asistencës në përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe

mekanismave praktik që mbrojnë dhe promovojnë trashëgiminë kulturore në Kosovë, në përputhje me standardet europiane.

PROGRAMI PËR INFORMIM

Programi i ATRC-së për informim realizohet përmes diskutimeve publike, konferencave, prezantimeve të donatorëve, publikimeve dhe uebfaqes së ATRC-së. Programi mbështet shkëmbimin e informatave ndërmjet OJQ-ve, institucioneve qeveritare, donatorëve, zyrtarëve dhe qytetarëve.

Buletini “Avokuesi”

ATRC, në baza tremujore, vazhdon publikimin e buletinit elektronik “Avokuesi”, i cili përmban aktivitetet kryesore të zhvilluara gjatë asaj periudhe. “Avokuesi” përcillet në mënyrë elektronike tek OJQ-të, mediat, institucionet qeveritare dhe lokale, partnerët dhe përkrahësit potencial brenda dhe jashtë Kosovës. “Avokuesi” mund të shkarkohet nga web faqja e ATRC:

www.advocacy-center.org.

Biblioteka

Biblioteka e ATRC-së posedon më shumë se 1.060 tituj librash, raportesh dhe materiale të tjera në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe për avokim, shoqëri civile, leadership, të drejtat e njeriut, vetëdijësim gjinor, etj. Për më shumë informata mund të shikoni web faqen e ATRC: www.advocacy-center.org.

Ueb faqja e ATRC

ATRC pasuron uebfaqen me informacione të reja, duke e bërë atë më të përshtatshme për shfrytëzuesit në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Në vitin 2014, ueb-faqja është vizituar 49.038 herë.

BOTIMET E ATRC GJATË VITIT 2014

Të gjeturat dhe rekomandimet e organizatave lokale nga aktivitetet e monitorimit të gjykatave

ATRC, në kuadër të projektit të Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për qasjen në drejtësi me titull “Ngritja e vetëdijes së qytetarëve dhe pjesëmarrjes në sistemin e drejtësisë”, ka publikuar raportin “Të gjeturat dhe rekomandimet e organizatave lokale nga aktivitetet e monitorimit të gjykatave”, i cili përfshin të gjeturat nga monitorimi i gjykatave i 12 organizatave lokale, të cilat janë përfutuese të rundit të dytë të granteve. Raporti përmban vrojtime të punës së organizatave lokale në monitorimin e gjykatave, prezantimin e të gjeturave dhe rekomandimet në lidhje me çështjet e trajtuara, si: rastet e trashëgimisë që kanë të bëjnë me gratë, dhuna në familje që kanë të bëjë me të drejtat e grave dhe femijëve, prerjet e pyjeve dhe degradimi i natyrës, komunikimi në mes gjykatave dhe qytetarëve, në çfarë niveli gjykatat i konsiderojnë të drejtat e komuniteteve jo shumicë, nivelin e zbatimit të ligjit kundër duhanit dhe a janë prioritet ose të lëna mënjanë lëndët e korrupsionit nga gjykatat.

Fituesit dhe humbësit: Kush përfiton nga korrupsioni i nivelit të lartë në sektorin e energjisë në Evropën Juglindore?

Raporti përmban analizë të fenomenit të korrupsionit në sektorin e energjisë në vendet e Evropës Juglindore, efektet dhe pengesat që korrupsioni i ka sjellë vendeve përkatëse në proceset integruese evropiane, detyrat dhe obligimet që shtetet kanë në raport me BE-në në luftimin e fenomenit të korrupsionit. Raporti gjithashtu përmban disa nga rastet korruptive më të përfolura dhe më të njohura në publik, të marra nga materialet të bëra publike, të cilat janë hetuar apo kanë qenë raste në procedura gjyqësore në vendet e rajonit.

Raporti është përgaditur nga ATRC dhe organizatat partnere nga gjashtë vendet e rajonit, në kuadër të projektit Politika Energjetike të Qëndrueshme në Evropën Juglindore (SEE SEP), i cili financohet nga Komisioni Evropian, UNDP dhe The Balkan Trust for Democracy.

ATRC NË MEDIA



E mërkurë, 9 korrik 2014
Zëri | www.zeri.info **17**

1 Në Raportin e ATRC-së flitet edhe për aferat korruptive në mes të UNMIK-ut dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Pas vitit 1999, Korporata Energjetike e Kosovës është menaxhuar nga menaxhmenti ndërkombëtar në emër të UNMIK-ut, jo Trutshclerit u emërua menaxher ndërkombëtar i KEK-ut, në vitin 2000

Skandalet e KEK-ut

Njëri nga skandalet më të mëdha të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) të hulumtuara nga gazeta "Zëri" është bërë pjesë e Raportit, rreth organizatës ATRC, rreth aferave korruptive energjetike në rajon

Prishtinë > Hulumtimet e gazetës "Zëri" rreth aferave korruptive me tenderë në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), janë pjesë e Raportit "Fituesit dhe Humbësit, kush përfiton nga korupsioni i nivelit

Afera UNMIK-KEK
Më tej në Raportin e ATRC-së flitet edhe për aferat korruptive në mes të UNMIK-ut dhe Korporatës Energjetike të



VIZITORENI EDHE ONLINE
WWW.BOTAPRESS.INFO

AKTUALE

GAZETA BOTAPRESS
E SHTUNË, 5 KORRIK 2014 **09**

Korrupsioni frikëson investitorët në sektorin e energjetikës

Korrupsioni i lartë në vendet Evropiane në sektorin e energjisë ka bërë që të largohen investitorët e njohur dhe ka rritur shpenzimet. Korrupsioni është pengesë drejtë Bashkimit Evropian.

Në debatin në temën "Fituesit dhe Humbësit", kush përfiton nga korrupsioni i nivelit të lartë në sektorin e energjisë në Evropën Juglindore, e publikuar nga

ATRC, morën pjesë përfaqësues të institucioneve të Kosovës, shoqërisë civile dhe medieve që u prezantua në një tryezë të mumbullakët në Prishtinë. Drejtori Ekzekutiv i ATRC, Kushtrim Kaloshi theksoi se ky raport përmban analizë të fenomenit të korrupsionit në sektorin e energjisë në vendet e Evropës Juglindore, efektet dhe pengesat që korrupsioni i ka sjellë vendeve për-

katëse në proceset integruuese evropiane. Përvoja e deritanishme theksuar në këtë raport dhe përmes rasteve konkrete dëshmon se projektet në fushën e energjisë në rajon shpesh janë shënuar nga korrupsioni i cili ka larguar investitorët e njohur dhe ka rritur shpenzimet. Pos tjerash ai shtoi se Shtetet palë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë planifikojnë rreth 28.8 miliard euro investime në energji nga viti 2012 deri në vitin 2020 në Ballkanin Perëndimor, ndërsa menaxhimi i këtyre investimeve do të jetë një sfidë ekzistenciale për shtetet e E.J.L-së. Të pranishmit u pajtuan me konkluzionet se ndërtimi i një infrastrukture moderne të energjisë duhet të shkojë në vijë paralele me ndërtimin e shtetit ligjor, që nënkupton: luftimin e korrupsionit, zbatimin e ligjeve, konkurrencën e lirë, trans-

parencën, informimin publik dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje etj. **L.Morina**



RAPORTI FINANCIAR



INDEPENDENT AUDITORS' REPORT

To the Board of Directors of Advocacy Training and Resource Centre

We have audited the accompanying financial statements of Advocacy Training and Resource Centre (ATRC), which comprise the balance sheet as at December 31, 2014, and the statement of revenue and expenditure, statement of changes in net assets and cash flow statement for the year then ended, and other explanatory notes.

Management's Responsibility for the Financial Statements

Management is responsible for the preparation and fair presentation of these financial statements in accordance with Kosovo Accounting Standards. This responsibility includes: designing, implementing and maintaining internal control relevant to the preparation and fair presentation of financial statements that are free from material misstatement, whether due to fraud or error; selecting and applying appropriate accounting policies; and making accounting estimates that are reasonable in the circumstances.

Auditor's Responsibility

Our responsibility is to express an opinion on these financial statements based on our audit. We conducted our audit in accordance with International Standards on Auditing. Those standards require that we comply with ethical requirements and plan and perform the audit to obtain reasonable assurance whether the financial statements are free from material misstatement.

An audit involves performing procedures to obtain audit evidence about the amounts and disclosures in the financial statements. The procedures selected depend on the auditor's judgment, including the assessment of the risks of material misstatement of the financial statements, whether due to fraud or error. In making those risk assessments, the auditor considers internal control relevant to the entity's preparation and fair presentation of the financial statements in order to design audit procedures that are appropriate in the circumstances, but not for the purpose of expressing an opinion on the effectiveness of the entity's internal control. An audit also includes evaluating the appropriateness of accounting policies used and the reasonableness of accounting estimates made by management, as well as evaluating the overall presentation of the financial statements.

We believe that the audit evidence we have obtained is sufficient and appropriate to provide a basis for our audit opinion.

In our opinion, the financial statements referred to above present fairly, in all material respects, the financial position of ATRC as of December 31, 2014 and the results of its operation for the year then ended in conformity with accounting principals generally accepted in Kosovo.

Fadri H. Consulting Associates

ACA - Audit & Consulting Associates
Prishtine, Kosovo
March 2015

PRISHTINE

Raportin e Auditimit mund ta shkarkoni nga web faqja zyrtare e ATRC-se: www.advocacy-center.org

BORDI I ATRC

ADRIANA KABASHI

Kryetare e Bordit

KRESHNIK BERISHA

Anëtar i Bordit

VJOSA MULLATAHIRI

Anëtare e Bordit

Prof. Dr. ISA ELEZAJ

Anëtar i Bordit

BESA SHAHINI

Anëtare e Bordit

VALBONA PUKA

Anëtare e Bordit

ALBAN IBRAHIMI

Anëtar i Bordit

PERSONELI I ATRC

Drejtor Ekzekutiv

Kushtrim Kaloshi

kushtrimk@advocacy-center.org

Drejtor Programi

Donika Podrimja

donika@advocacy-center.org

Menaxher i Financave dhe Administratës

Gani Asllani

gani@advocacy-center.org

Menaxhere e Programit të Trajnimeve

Nora Susuri

nora@advocacy-center.org

Koordinator e Projektit

Alketa Bala

alketa@advocacy-center.org

Koordinator e Projektit

Imelda Midha

imelda@advocacy-center.org

Koordinator i ekipit për Monitorimin e të kthyerve

Hysen Hamzaj

hysen@advocacy-center.org

Monitoruese

Magbule Pllana

magbule@advocacy-center.org

Monitoruese

Rrezarta Krasniqi

rrezarta@advocacy-center.org

Monitoruese

Zaid Kulinxha

zaid@advocacy-center.org

Monitoruese

Naim Rashiti

zaid@advocacy-center.org

Asistent i projektit

Dren Dinarama

dren@advocacy-center.org

TI & Administratë

Arsim Kosumi

arsim@advocacy-center.org

Praktikante

Anyla Beqa

internship@advocacy-center.org

Praktikante

Etrit Haxhiu

internship@advocacy-center.org



Ky raport u mundesua nga kontributi i stafit të ATRC-së, përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e ATRC-së. Të gjitha të drejtat e rezervuara © 2014, ATRC-Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim, Prishtinë - Kosovë Raporti Vjetor 2014 i ATRC-së është përgaditur nga stafi i ATRC-së

